



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER REDION A. ZALOSH NJA  
ADRESA NR.6, F. QELQIT, NR.54,  
NR.2, NR.7/1  
TEL: 695610921

# REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 397

Nr. koleksioni: 205

Tirane më 15/04/2021

**Ligjet referuese:**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"

\*Akti notarial përbëhet nga 10 fletë



A2021052630018086005

Handwritten text in the top right corner, possibly a date or page number.



A2021052630018086005

Sot me date 15.04.2021, në Tiranë para meje Noter REDION A. ZALOSHINJA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në airanë, NR.6, F. QELQIT, NR.54, NR.2, NR.7/1, në mbështetje të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", u hartua ky akt themelimi dhe statut nga ortakja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar :

### **THEMELUESJA:**

Arkida Ligaçi, atësia Ali, amësia Artije, shtetase Shqiptare, lindur në Delvinë dhe banuese në TIRANË, me adresë Thoma Koxhaj 03920267; Nd. 42; H. 12; Ap. 21; Kashar; Yzberish; 1050; Tiranë, lindur më 22/12/1984, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036178590 dhe nr. personal I46222097P.

## **AKT THEMELIMI** **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR** **ALUS Sh.P.K BPO & Logistics**

### **NENI 1** **THEMELIMI DHE EMRI I SHOQËRISË**

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " ALUS Sh.P.K BPO & Logistics  
Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me Aktin e Themelit dhe Statutin e saj.

### **NENI 2** **SELIA**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rr' Sabri Preveza", Nd. 14, Hyrja 50, Apt 20, Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 14. Tiranë.

### **NENI 3** **FORMA**

Kjo Shoqëri është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

### **NENI 4** **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria ALUS Sh.P.K BPO & Logistics do të ketë si objekt të veprimtarisë:

- Kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në baze të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në: Të ndermarre veprimtari biznesi si një shoqëri e përgjithshme financiare dhe tregtare, duke përfshirë, por jo duke u limituar vetëm në shërbime eeb financiare dhe tregtare në bashkëlidhje me njëra - tjetren ose si sipërmarrje të ndara dhe të dalluara të të gjithave ose vetëm të ndonjërës nga si me poshtë vijon: komisionere, financiare, agjente financiare, kandidat, administrues i besuar, agjent, administrator, marrës për llogari, ose në të kundërt, në emër të korporatave private ose publike, shoqërive ose personave.
- Të sigurojë shërbime në nderlidhje këtu, qoftë si një biznes i vetëm, qoftë si biznese të dallueshme dhe të ndara, në ccdo anë të globit. Logjistike ( transport njëjerezor dhe mallrash ),



A2021052630018086005

Procesi outsourcing I bizneseve (BPO), menaxhim database per te trete ( kompani vendase dhe te huaja).

- Projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nepermjet shfrytezimit te te gjitha instrumentave, perfshire marketingun telefonik dhe instrumenta te tjera te marketingute drejtperdrejte; Projektimi, realizimi dhe shit-blerja e sherbimeve te call center, si inbound dhe outbound. Projektimi, administrimi dhe shit-blerja e produkteve dhe sherbimeve telematike, informatike dhe te marketingut, ne fushen telefonike, informatike dhe tregtare; Administrimi dhe tregtimi i bankave te te dhenave te finalizuara per marketing; Perfaqesimin dhe sherbime ne fushen e telekomunikacioneve dhe te prodhimeve e sherbimeve telematike.
- Per te realizuar objektin e aktivitetit te saj, Shoqeria mund te veproje ne Shqiperi dhe jashte, dhe te kryeje çdo aktivitet tjeter te nevojshem, te lidhur, instrumental, te perafert, elementar, ose sidoqofte te dobishem, per shembull:
- Te ofroje garanci reale dhe/ose personale si per detyrime te vetat, ashtu edhe per te tretet.
- Te marre persiper, te lejoje dhe/ose te heqe dore nga pjesemarrje direkte ose indirekte ne shoqeri te tjera dhe ndermarrje, si Shqiptare ashtu edhe te huaja, qe kryejne veprimtarine e tyre ana tyre, me qellim qe te lehtesojne realizimin e objektit social.

#### NENI 5 KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pakufizuar (e pacaktuar), duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, me perjashtim te rastit te mbarimit te saj sipas kushteve te parashikuara ne ligj ose me vendim te ortakeve te shoqerise.

#### NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqdrise do te jete 100,000 (Nje qind mije) Leke, i zoteruar nga ortakët si me poshte: Emri, Mbiemri % cite zoteron Kuotat qe zoteron **Arkida Ligaçi** 100 % 1 kuote  
Ky kapital Eshte i ndare ne 1 (nje) kuote te zoteruar 100% nga ortakët i vetem sipas tabelës me siper.  
Ortakët themelues **Arkida Ligaçi**, zoteron 1 kuote, me vlere te pergjithshme 100,000 Leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar.

#### ORGANI DREJTUES NENI 7 ASAMBLEJA E ORTAKUT TE VETEM

Asambleja e ortakeve te shoqerise i ushtron te gjitha kompetencat qe i njihen me ligj per shkak te kesaj cilesie.

#### NENI 8 ADMINISTRATOR

Shoqeria do te drejtohet nga administratori **Znj. Arkida Ligaçi**, atësia Ali, amësia Artije, shtetase Shqiptare, lindur në Delvinë dhe banuese në TIRANË, me adresë Thoma Koxhaj 03920267; Nd. 42;



A2021052630018086005

H. 12; Ap. 21; Kashar; Yzberish; 1050; Tiranë, lindur më 22/12/1984, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036178590 dhe nr. personal I46222097P.

**NENI 9**  
**FITIMI**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve te kesaj shoqerie sipas kontributit dhe pjeses takuese qe kane ne kete shoqeri.

**NENI 10**  
**BILANCI**

Viti financiar fillon ne 1 janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti.  
Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet hartuara nga eksperti kontabel, miratohen nga asambleja e ortakut te vetemte kesaj shoqerie. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

**NENI 11**  
**KONFLIKTET**

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen ne Gjykata e Shkalles se Pare, sipas statutit te shoqerise, kontrates te lidhur me palet dhe ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

**NENI 12**  
**VULA DHE SHENJA DALLUESE**

Shoqeria ka vulen dhe shenjat e veta dalluese.

**NENI 13**

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kompetente.

**NENI 14**

Akti i themelimit u perpilua ne kater kopje origjinale ne gjuhen shqipe me vlere te njejte.

ORTAKET E SHOQERISE

Znj. Arkida Ligaçi

*Arkida Ligaçi*



**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**ALUS Sh.P.K BPO & Logistics**

**EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI**

**Neni 1**

**Data e themelimit, Emertimi dhe Themeluesit**

Shoqeria ALUS Sh.P.K BPO & Logistics krijohet ne date 13.04.2021 nga ortaku si me poshte : **Znj. Arkida Ligaçi**, atësia Ali, amësia Artije, shtetase Shqiptare, lindur në Delvinë dhe banuese në TIRANË, me adresë Thoma Koxhaj 03920267; Nd. 42; H. 12; Ap. 21; Kashar; Yzberish; 1050; Tiranë, lindur më 22/12/1984, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036178590 dhe nr. personal I46222097P.

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

- 2.1 Shoqeria eshte person juridik shqiptar.  
2.2 Shoqeria gezon te drejta si person juridik shqiptar, qe prej dates ne te cilen kryhet regjistrimi i saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.  
2.3 Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentet themeluese (Akt Themelimi dhe Statut).

**Neni 3**

**Forma e shoqerise**

- 3.1 Shoqeria do te kete formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

**Neni 4**

**Objekti**

- 4.1 Shoqeria ALUS Sh.P.K BPO & Logistics do te kete si objekt te veprimtarise:
- Kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, duke perfshire por pa u kufizuar ne: Te ndermarre veprimtari biznesi si nje shoqeri e pergjithshme financiare dhe tregtare, duke perfshire, por jo duke u limituar vetem ne sherbime eeb financiare dhe tregtare ne bashkelidhje me njera - tjetren ose si sipermarrje te ndara dhe te dalluara te te gjithave ose vetem te ndonjeres nga si me poshte vijon: komisionere, financiere, agjente financiare, kandidat, administrues i besuar, agjent, administrator, marres per llogari, ose ne te kundert, ne emer te korporatave private ose publike, shoqerive ose personave.
  - Te siguroje sherbime ne nderlidhje ketu, qofte si nje biznes i vetem, qofte si biznese te dallueshme dhe te ndara, ne ccdo ane te globit. Logjistike ( transport njerezor dhe mallrash ), Procesi outsourcing i bizneseve (BPO), menaxhim database per te trete ( kompani vendase dhe te huaja).
  - Projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nepermjet shfrytezimit te te gjitha instrumentave, perfshire marketingun telefonik dhe instrumenta te tjera te marketingute drejtperdrejte; Projektimi. realizimi dhe shit-blerja e sherbimeve te call center, si inbound dhe



A2021052630018086005

outbound. Projektimi, administrimi dhe shit-blerja e produkteve dhe shërbimeve telematike, informatike dhe të marketingut, në fushën telefonike, informatike dhe tregtare; Administrimi dhe tregtimi i bankave të të dhënave të finalizuara për marketing; Perfaqësimin dhe shërbime në fushën e telekomunikacioneve dhe të prodhimeve e shërbimeve telematike.

- Për të realizuar objektin e aktivitetit të saj, Shoqëria mund të vepronte në Shqipëri dhe jashtë, dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm, të lidhur, instrumental, të përafert, elementar, ose sidoqoftë të dobishëm, për shembull:
- Të ofrojë garanci reale dhe/ose personale si për detyrime të vetat, ashtu edhe për të tretet.
- Të marrë përsiper, të lejojë dhe/ose të heqë dorë nga pjesëmarrje direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe ndërmarrje, si Shqiptare ashtu edhe të huaja, që kryejnë veprimtari të tyre ana të tyre, me qëllim që të lehtësojnë realizimin e objektit social.

### Neni 5 Kohezgjatja

5.1 Shoqëria ALUS Sh.P.K BPO & Logistics kryen veprimtari të saj tregtare për një periudhë kohore të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.

5.2 Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me 1 vendim të Asambleja e Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### Neni 6 Selia

6.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rr' Sabri Preveza", Nd. 14, Hyrja 50, Apt 20, Tiranë, Njesia Bashkiake nr. 14. Tiranë. Me vendim të Administratorit selia e shoqërisë mund të ndryshohet, mund të hapen dege, dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

### Neni 7 Vula e Shoqërisë

7.1 Shoqëria do të ketë vula të saj duke shënuar në të emërtimin tregtar ose iniciale.

## **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRANSFERIMI I TYRE**

### Neni 8 Kapitali Themeltar

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100,000 (Një qind mijë) Leke, i zotëruar nga ortakët si më poshtë: Emri, Mbiemri % i cili zotëron Kuotat që zotëron **Arkida Ligaçi** 100 % 1 kuote

8.2 Ky kapital është i ndarë në 1 (një) kuote të zotëruar 100% nga ortakët i vetëm sipas tabelës më sipër. Ortakët themelues **Arkida Ligaçi**, zotëron 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 100,000 Leke, që përben 100 % të kapitalit themeltar.

8.3 Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër ose në arken e shoqërisë.





A2021052630018086005

**Neni 9**  
**Kuotat, te drejtat e lidhura me to**

9.1 Çdo kuote jep te drejten e nje vote per te mane vendime sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Te gjitha votat do te ushtrohen nga ortakët sipas zoterimeve.

**Neni 10**  
**Kuotat, Fitimi, Transferimi i kuotave**

10.1 Kuotat e kapitalit te shocierise mund te fitohen nepermjet kontributit ne kapitalin e shoqerise, shitblerjes, trashëgimise, dhurimit, apo çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

**ORGANI DREJTUES**

**Neni 11**  
**Asambleja e Pergjithshme. Thirrja e mbledhjes. Marrja e vendimeve. E drejta e votes**

11.1 Asambleja e Pergjithshme, si organ kryesor i shoqerise sipas ligjit "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare" perfaqesohet ne kete shoqeri nga ortakët.

11.2 Asambleja e Pergjithshme thirret me shkrese jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes, ne adresat e percaktuara ne dispoziten "Njoftimet" me poshte. Njoftimi duhet te permbaje: ditën, orën, vendin ku do te mbahet mbledhja si dhe rendin e dites. Njoftimi behet nga Administratori i shoqerise apo nga çdo ortak i cili perfaqeson te pakten 5% (pese perqind) te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme.

11.3 Asambleja e Pergjithshme duhet te thirret te pakten nje here ne vit per te vendosur per çeshtje te tilla si miratimi i bilancit dhe pasqyrave financiare, miratimi i raportit te auditimit te shoqerise.

11.4 Mbledhjet mbahen ne seline e shoqerise, apo edhe ne nje vend tjeter te njohur nga ortaku i vetem.

11.5 Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme.

11.6 Asambleja e ortakeve te shoqerise i ushtron te gjitha kompetencat qe i njihen me ligj per shkak te kesaj cilesie.

**Neni 12**  
**Kompetencat e Asamblese**

12.1 Asambleja e Pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine ne lidhje me çeshtjet e meposhtme:

1. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
2. Ndryshimin e Statutit;
3. Emerimin/shkarkimin e Administratorit, eksperteve kontabel, likujdatoreve;
4. Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratoret pershire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
5. Miratimin e pasqyrave financiare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
6. Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
7. Kryerjen e kontroll-revizionit financiar te shoqdrise me eksperte te caktuar prej saj;
8. Te vendose per zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;





- 9. Te vendose per riorganizimin dhe prishjen e shoqdrise;
- 10. Çeshtje te tjera qe jand te rëndesishme per aktivitetin tregtar te shoqerise.

**Neni 13**  
**Perfaqesimi ne Asamble**

13.1 Ortaku mund te perfaqesohet ne mbledhje, ne rastet kur e ka te pamundur pjesemarrjen personalisht ne mbledhje, nga nje person i trete ose edhe nga nje ortak tjetër shoqerie. Autorizimi duhet te kete te percaktuar qarte kompetencat e perfqesuesit si dhe te drejtat e tij lidhur me vendimarrjen ne mbledhje.

**ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

**Neni 14**  
**Administrimi i shoqerise**

14.1 Shoqeria administrohet nga nje Administrator i zgjedhur nga Asambleja e Pergjithshme. **Znj. Arkida Ligaçi**, atësia Ali, amësia Artije, shtetase Shqiptare, lindur në Delvinë dhe banuese në TIRANË, me adresë Thoma Koxhaj 03920267; Nd. 42; H. 12; Ap. 21; Kashar; Yzberish; 1050; Tiranë, lindur më 22/12/1984, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036178590 dhe nr. personal I46222097P. Afati i ushtrimit te detyres eshte 5 (pese) vjet me te drejte ripërteritje.

**Neni 15**  
**Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit. Pergjegjesite**

- 15.1 Administratori ushtron kompetencat e meposhtme:
- 1. Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
  - 2. Vepron me te tretet ne emer dhe per llogari te shoqerise brenda kompetencave te parashikuara ne statut apo/dhe ne ligj in "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
  - 3. Kryen emerimin dhe shkarkimin nga puna te punemarresve te shoqerise.
  - 4. Jep urdhra dhe udhezime punemarresve dhe vendos sanksione ndaj tyre, ne perputhje me kontratat e punes dhe rregulloret e brendshme te shoqerise;
  - 5. Drejton dhe organizon punen ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko-financiare;
  - 6. Te raportoje para Asamblese se Pergjithshme sa here qe Asambleja e kerkon si dhe ne rastet kur eshte i nevojshem raportimi ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rëndesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
  - 7. Te zbatoje vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme;
  - 8. T'i paraqese ne menyre te rregullt dhe ne kohe te pershtatshme Asamblese se Pergjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancin dhe llogarite vjetore si dhe te pergjigjet per to;
  - 9. Te ushtroje te drejta dhe detyrime te tjera te percaktuara nga ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
  - 10. Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjit dhe statutit dhe per faje te kryera gjate administrimit sipas parashikimit te ligjit nr. 9901 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjeve te tjera ne fuqi.



A2021052630018086005



**Neni 16**  
**Mbarimi i mandatit te Administratorit**

16.1 Mandati i Administratorit perfundon:

- me mbarimin e afatit;
- me shkarkimin e tij nga Asambleja e Pergjithshme;
- kur vete Administratori jep doreheqjen vullnetarisht;
- sipas menyrove te tjera parashikuar nga ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, DIVIDENTET**

**Neni 17**  
**Viti Financiar**

17.1 Veprimet financiare mbyllen me 31 dhjetor te çdo viti. Administratori merr masa lidhur me nxjerrjen e bilancit te hartuar konform ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

**Neni 18**  
**Librat e Shoqerise**

18.1 Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec Librit te Shoqerise, ne te cilin shenohet emri i plote i ortakeve, kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakeve edhe dokumentacionin kontabel dhe librat e tjere.

**Neni 19**  
**Bilanci**

19.1 Viti financiar filion ne 1 janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti.

19.2 Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet hartuara nga eksperti kontabel, miratohen nga asambleja e ortakeve. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

**Neni 20**  
**Dividentet**

20.1 Ortaket e shoqerise miratojne llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit. Ata percaktojne fitimin e vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per: rezerven sipas ligjit ose te percaktuar nga vete asambleja e ortakeve, fondet e tjera qe shihen te nevojshme dhe, nga ana tjeter i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme, Keshtu asambleja e ortakeve percakton dhe dividentin.



## **MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

### **Neni 21**

#### **Mbarimi i Shoqerise dhe Likudimi i saj**

21.1 Shoqeria ALUS Sh.P.K BPO & Logistics mbaron:

1. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
2. Me hapjen e procedurave te falimentimit;
3. Sipas shkaqeve te tjera te parashikuara nga ligji "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

21.2 Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi asambleja e ortakeve cakton nje ose disa likujdues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likujdimit, asambleja e ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit. Mbas pagimit te kreditoreve asambleja e ortakeve mban pjesen e mbetur te kapitalit.

### **Neni 22**

#### **Njoftimet**

22.1 Njoftimi per ortakun duhet te kryhet sipas adreses se percaktuar ne Nenin 6 te ketij statuti.

22.2 Ortaku eshte i detyruar te njoftoje ndryshimet ne adresen e tij.

### **Neni 23**

#### **Te ndryshme**

23.1 Per çeshtje qe nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut, gjejne referim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

23.2 Shoqeria ALUS Sh.P.K BPO & Logistics regjistrohet sipas neneve 26, 28, 32 e 35 te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" 20.3 Statuti u hartua ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe me vlere te njejte juridike.

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



A2021052630018086005

SHQIPËRIE  
ALBANIJA  
TIRANË

**ORTAKJA E SHQËRISË:**

Arkida Ligaçi

Arkida Ligaçi  
*[Handwritten signature]*



**NOTER:**

REDION A. ZALOSH NJA

*[Large handwritten scribble]*

